

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Nr.prok. 216-26-2603-1-3-6** nr, brendshem.:

Sa i përket tenderit për **Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së RITENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"RIMI ALTEX" Shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deshmoret e kombit

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

+383 44 164 991

(Numri Telefonit)

Trim Goga

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

rimi-altex@hotmail.com

(Adresa elektronike)

70000

(Kodi postar)

(Nu



(Nënshkrimi dhe

15.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi per kontrate 22.04.2026
 - Afati i fundit per dorezim te tenderit 04.05.2026
 - Njoftimi i AK .-B58 Njoftimi per dhenje te kontrates 02.07.2026
 - Kriteret e Dhenies se tenderit:Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët ☒

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- Me datën 06.07.20256 nepermjet portalit të KRPP-se kemi derguar Kerkesen per Rishqyrtim, AK me daten 08.07.2026 na kthen Vendimin dhe Kerkesen tone per Rishqyrtim e refuzon si te pabazuar. Ne Vendimin e Kerkese per Rishqyrtim shkruan: REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "RIMI ALTEX." e datës 06.07.2026 kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 02.07.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së" me nr. të prokurimit 216-26-2603-1-3-6 .Justifikimi i AK Sa i përket pretendimeve tuaja ju njoftjmë se: : Ju njoftojmë se i gjithë procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje të plotë me Vendimine OSHP-së dhe raportin e ekspertit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vlersimi i aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me Ligjin prokurimit Publik,

- Shkelja e nenit 1-Qellimi i LPP-se të amendamentuar
- Shkelja e Nenit 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti (LPP)
- Shkelja e nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të amendamentuar

- *Nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tendereve te LPP te amandamentuar,*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabje shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shoqëria "RIMI ALTEX" Shpk me seli në Ferizaj (me tej: Kerkuesi), brenda afatit ligjor të paraparë më dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 për ANKESE, respektivisht, brenda afatit të lënë për ANKESA paraqet këtë:

ANKESË

kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe kundër vendimit për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik NPT Printeks, për shkak të:

- *konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;*
- *zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik;*
- *shkeljes së parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv të ofertave.*

PROPOZOJME QE PANELI SHQYRTUES

- 1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar;*
- 2. Ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim;*
- 3. Ta anulojë vendimin për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik NPT Printeks;*
- 4. Ta kthejë lëndën në rivlerësim;*
- 5. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që vlerësimin ta bëjë vetëm mbi bazën e kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe provave objektive e të verifikueshme.*

JUSTIFIKIM.- ARSYETIM.-Kompania "RIMI-ALTEX" SH.P.K. ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit të lartcekur dhe fillimisht ishte rekomanduar për dhënie të kontratës, pasi Autoriteti Kontraktues kishte konstatuar se Operatori Ekonomik NPT Printeks nuk i plotësonte specifikimet teknike të detyrueshme, konkretisht për pozitën nr. 7 "Pallto

trench klasike me gjatësi mesatare”.

Autoriteti Kontraktues kishte vlerësuar se mostra e Operatorit Ekonomik të rekomanduar nuk i përmbushte kërkesat e Dosjes së Tenderit për përdorim gjithësezonal dhe, për këtë arsye, e kishte eliminuar atë nga procedura.

Pas ushtrimit të ankesës në OSHP nga ana e NTP Printeks, eksperti shqyrtues ka konstatuar se, sipas hulumtimeve të tij, një pallto trench për përdorim gjithësezonal nuk është domosdoshmërisht e pajisur me shtresë izolimi, duke rekomanduar kthimin e lëndës në rivlerësim.

Bazuar në këtë konstatim, pa u paraqitur prova të reja teknike, pa u administruar analiza laboratorike dhe pa u kryer ndonjë ekspertizë profesionale, Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar qëndrimin e tij fillestar dhe me vendimin e datës 02.07.2026 ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik NPT Printeks.

Vlerësojmë se ky vendim është i pambështetur në prova objektive dhe, si rrjedhojë, është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

Mungesa e provave teknike dhe objektive

Konstatimi i ekspertit shqyrtues mbështetet në formulime të përgjithshme si:

- *“Kemi bërë hulumtime”;*
- *“Kemi ardhur në përfundim”.*

Megjithatë, në raport nuk identifikohet:

- *asnjë standard EN, ISO apo ASTM;*
- *asnjë ekspertizë tekstile;*
- *asnjë analizë laboratorike;*
- *asnjë test fizik apo termik;*
- *asnjë publikim profesional apo shkencor.*

Një përfundim teknik nuk mund të mbështetet vetëm në bindjen personale, por duhet të mbështetet në prova objektive, të verifikueshme dhe teknikisht të argumentuara.

Eksperti nuk ka provuar se mostra e Operatorit Ekonomik NPT Printeks përmbush kërkesën për përdorim gjithësezonal. Fakti se një pallto trench nuk ka domosdoshmërisht shtresë izolimi nuk provon automatikisht se ajo përmbush kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit.

Pikërisht kjo ishte kërkesa teknike e Autoritetit Kontraktues dhe pikërisht kjo nuk është provuar me asnjë metodë objektive.

Mungesa e arsytimit nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues, me vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, është kufizuar vetëm në konstatimin se procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje me vendimin e OSHP-së nr. 2026/0361 dhe raportin e ekspertit shqyrtues.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret lidhur me pretendimet tona të reja, të ngritura pas qasjes në mostrat e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë më datë 06.07.2026.

Në veçanti, nuk është dhënë asnjë përgjigje lidhur me:

- *dyshimet serioze për ndërhyrje në etiketën e kostumit për shoferë;*
- *mungesën e dokumentacionit që dëshmon se kravata është nga materiali i kërkuar;*
- *mungesën e dokumentacionit teknik që vërteton se këpucët janë nga lëkura natyrale;*
- *pretendimet tona lidhur me faktin se palltoja trench nuk përmbush kërkesat për përdorim gjithësezonal;*

- kërkesën tonë për verifikim të pavarur dhe ekspertizë profesionale.

Konstatimet e reja pas qasjes në mostra

Më datë 06.07.2026, Autoriteti Kontraktues na mundësoi qasje në mostrat e Operatorit Ekonomik të rekomanduar. Gjatë ekzaminimit fizik të mostrave, konstatuam një sërë parregullsish dhe mospërputhjesh me kërkesat e Dosjes së Tenderit, për të cilat janë siguruar prova fotografike.

Pozicioni nr. 1 – Kostumi për shoferë

Nga ekzaminimi vizual janë konstatuar dyshime serioze se etiketa e përbërjes së materialit është zëvendësuar ose riqepur pas prodhimit, për shkak se:

- vërehen gjurmë të qepjeve të mëparshme;
- hapësira ku ka qenë etiketa origjinale është më e gjerë;
- janë të dukshme vrimat dhe gjurmët e qepjes;
- qepja aktuale nuk përputhet me mënyrën standarde të prodhuesit;
- vërehen fije të pahequra dhe dallime ndërmjet fijeve origjinale dhe atyre të përdorura më vonë.

Këto rrethana krijojnë dyshime serioze mbi autenticitetin e etiketës dhe kërkojnë verifikim profesional.

Pozicioni nr. 3 – Kravata

Dosja e Tenderit kërkon kravatë nga materiali mëndafsh.

Nga ekzaminimi i mostrës nuk rezulton asnjë etiketë, deklaratë e prodhuesit apo dokument teknik që vërteton përmbushjen e kësaj kërkesë.

Pozicioni nr. 4 – Këpucët

Për mostrën e këpucëve nuk është gjetur asnjë dokument teknik, certifikatë apo deklaratë e prodhuesit që vërteton se materiali është lëkurë natyrale.

Pozicioni nr. 7 – Pallto trench klasike

Edhe pas ekzaminimit fizik të mostrës, mbetemi në qëndrimin se palltoja e ofertuar nuk i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit për përdorim gjithësezonal dhe nuk është e përshtatshme për t'u veshur mbi kostum. Mandej siç mund të verohet ka shume nderhyrje

Ne vazhdim do ti shihni provat e nderhyrjeve si dhe mostrave tjera te cilat nuk I plotesojne kerkesat e AK:



Foto 1.



Foto 2



Foto 3



Foto 4



Foto 5



Foto 6



Foto 7.




Foto 8.



Foto 9.



Foto 10



Foto 11



Foto 12



Foto 13.

Foto 14



Foto 15

Shkelja e parimeve të Ligjit për Prokurimin Publik

Vendimi i Autoritetit Kontraktues cenon parimet themelore të përcaktuara në nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe kërkesat e nenit 104 të këtij ligji, sipas të cilave procedura e shqyrtimit duhet të zhvillohet në mënyrë të drejtë, të ligjshme, transparente dhe efektive.

Ndryshimi i qëndrimit të Autoritetit Kontraktues, pa prova të reja objektive dhe pa administrimin e ekspertizave profesionale, cenon sigurinë juridike dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Duke u bazuar në të gjitha arsyet e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim.

Kërkesë lidhur me angazhimin e ekspertit shqyrtues

Duke pasur parasysh se në procedurën paraprake eksperti shqyrtues tashmë ka dhënë vlerësimin e tij lidhur me çështjet kryesore të kontestuara, ndërsa ankesa aktuale përmban edhe pretendime dhe prova të reja që lidhen me përputhshmërinë teknike të mostrave të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që, nëse e konsideron të nevojshme angazhimin e ekspertit shqyrtues, të shqyrtojë mundësinë e caktimit të një eksperti tjetër të pavarur.

Kjo kërkesë paraqitet vetëm me qëllim të sigurimit të një shqyrtimi sa më objektiv, të paanshëm dhe gjithëpërfshirës të pretendimeve dhe provave të paraqitura në këtë procedurë.

Bashkëngjitur:

1. Vendimi i Autoritetit Kontraktues;
2. Kërkesa për Rishqyrtim;
3. Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0361;
4. Raporti i ekspertit shqyrtues;
5. Fotografitë e mostrave;
6. Provat e tjera relevante.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani shumë serioze, me një përvojë shume te gjate në këtë fushë

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.